# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6808
E shtunë, 21 janar 2023
çmimi 0.40


## Nis punën grupi punues për vetingun FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# EMISARËT, PAS TAKIMIT ME KURTIN: KEMI PRITUR MË SHUMË MIRËKUPTIM PËR PROPOZIMIN E BE-së FAQE 4-5-6



I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, ka thënë të premten në Prishtinë se ka pritur më shumë mirëkuptim për mundësitë që i ofron propozimi i BE-së për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Lajçaku, i shoqëruar edhe nga i dërguari i posaçëm amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe këshilltari i presidentit francez Emannuel Macron dhe nga ai i kancelarit gjerman Olaf Scholz, zhvilloi një takim më shumë se dy orësh me kryeministrin Kurti në kuadër të përpjekjeve për t'i nxitur bisedimet Kosovë - Serbi për normalizimin e marrëdhënieve

DËMET DHE PASOJAT E SHKAKTUARA NGA RESHJET E SHIUT NË DISA KOMUNA TË KOSOVËS JANË JASHTËZAKONISHT TË MËDHA FAQE 4-5

# NIS VLERËSIMI I DËMEVE PAS VËRSHIMEVE

Në disa komuna të Kosovës janë krijuar komisione për t'i vlerësuar dëmet e shkaktuara nga vërshimet ditët e fundit. Si pasojë e shirave të rrëmbyeshëm, vërshimet kanë prekur më së shumti komunën Skenderaj, Mitrovicë e Jugut, Klinë dhe Istog, duke dëmtuar ekonomi familjare, biznese, kultura bujqësore dhe infrastrukturën rrugore. Qytetarët, ekonomitë familjare dhe bizneset, përveç humbjes dhe dëmtimit të pronave të tyre, po ballafaqohen edhe me mungesë të ujit të pijshëm dhe të energjisë elektrike



## AKTUALE



### SHBA-ja i ofron Ukrainës ndihmë ushtarake në vlerë të 2.5 miliardë dollarëve F. 2

### Chollet: Marrëveshja përfundimtare do të kërkojë zgjidhje të vështira dhe guxim politik F.3

### LDK-ja për paralajmërimet për atentat: Të bëhen hetime të pavarura F. 6

## EKONOMI



### ASK-ja nis takimet konsultative me përfaqësuesit e komunave për regjistrimin e popullsisë F. 8

### Kapen barna të kontrabanduara F. 8

## SPORT



### Derbi i 'zjarrtë' në mes të Pejës dhe Trepçës F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
044/256-051
044/367-061
028/532-617
FABRIKA E LLAQEVE MITROVIC
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

Digital Ag
Endrit Shaqiri
+38344685122

# ShBA-ja i ofron Ukrainës ndihmë ushtarake në vlerë të 2.5 miliardë dollarëve

**Uashington, 20 janar -** Shtetet e Bashkuara kanë paraqitur ndihmën e re ushtarake për Ukrainën në vlerë të 2.5 miliardë dollarëve. Aty përfshihen qindra pajisje të armatosura dhe ndihmë shtesë për sistemin ajror të Ukrainës. Në ndihmën e fundit përfshihen 59 pajisje luftarake Bradley dhe 90 transportues të blinduar Stryker, ka thënë Departamenti amerikan i Mbrojtjes.

Në ndihmën e fundit përfshihen edhe sistemet raketore HIMARS, sistemet për mbrojtje ajrore Avenger, mijëra predha të artilerisë dhe 2 000 raketa, ka thënë Departamenti i Mbrojtjes.

Në total, Shtetet e Bashkuara kanë ndarë 27 miliardë dollarë ndihmë për Ukrainën prej kur Moska ka nisur luftën në shkurt të vitit të kaluar.

Aleatët perëndimorë kanë ofruar po ashtu armë në vlerë të miliarda dollarëve për Ukrainën. Pas shqetësimeve se forcat ruse mund të rigrupohen dhe të nisin sulm të madh në javët në vijim, Ukraina është duke kërkuar më shumë ndihmë për ta luftuar pushtimin rus.

Përgjatë udhëtimit të tij në Uashington, në dhjetor të vitit të kaluar, presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, i ka thënë Kongresit amerikan se ndihma për Ukrainën është investim në demokraci dhe nuk është bamirësi.

Presidenti rus, Vladimir Putin, e quan luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



# Japonia synon ta ndryshojë statusin ligjor për Covid-19

**Tokio, 20 janar -** Kryeministri japonez Fumio Kishida ka bërë me dije planet për ta ndryshuar statusin ligjor për Covid-19, sëmundjen që shkakton koronavirusi, duke e trajtuar atë njëjtë sikurse gripin sezonal.

Një hap i tillë do të mund të relaksojë edhe më shumë masat për luftim të pandemisë teksa Japonia tenton t'i kthehet jetës normale.

Në mesin e masave që aktualisht zbatohet në Japoni është vendosja e maskës.

Kishida ka thënë se ka udhëzuar ekspertët dhe zyrtarët qeveritarë që të diskutojnë detajet për ndryshimin e statusit për



Covid-19.

Ky ndryshim do ta shfuqizonte masën e vetizolimit dhe do t'i mundësonte pacientëve me koronavirus që të kërkojnë trajtim në secilin special, për dallim prej tani që mund të drejtohen vetëm në disa institucione të specializuara.

"Në mënyrë që t'i kthehemi jetës normale në Japoni, ne do të studiojmë masa konkrete që gradualisht të kalojmë në fazën e re", ka thënë Kishida.

Ai i ka bërë këto deklarata teksa Japonia përballet me shifra rekorde të infektimit dhe vdekjeve, në atë që konsiderohet vala e tetë prej shpërthimit të pandemisë.

Sipas Ministrisë japoneze të Shëndetësisë, shifrat ditore të vdekjeve kanë arritur deri 503 në fundjavën e kaluar.

Ekspertët besojnë se kjo rritje mund të lidhet me përkeqësim të sëmundjeve kronike te pacientët e moshuar.

Në Japoni Covd-19 kategorizohet si sëmundje e shkallës së dytë, bashkë me SARS-in dhe tuberkulozin.

Pacientët me këto sëmundje duhet të izolohen dhe shpërthimi i këtyre sëmundjeve u mundëson qeverive lokale që të shpallin masa emergjente.

Kategorizimi i Covid-19 në shkallën e pestë nënkupton edhe heqjen e masave.

Për koronavirusin e ri është raportuar për herë të parë në dhjetor të vitit 2019 në Vuhan të Kinës.

Organizata Botërore e Shëndetësisë e pati shpallur koronavirusin pandemi më 11 mars të vitit 2020.

Më shumë se 6.7 milionë njerëz kanë vdekur që prej shpërthimit të pandemisë në gjithë botën.

Shtetet e Bashkuara kanë regjistruar numrin më të madh të viktimave, të përcjella nga India dhe Brazili.

# Jep dorëheqje bashkudhëheqësi i "Netflix"-it

**Los Gatos, 20 janar -** Reed Hastings ka dhënë dorëheqje nga roli i tij si bashkudhëheqës i "Netflix"-it, kompani në të cilin ka kontribuuar për më shumë se 25 vjet. Njoftimi i tij vjen teksa "Netflix"-it i është rritur numri i abonuesve në fund të vitit të kaluar.

Për shkak të vështirësive ekonomike, shumë njerëz është parashikuar se do të hiqnin dorë nga shërbimet e "Netflix"-it. Mirëpo platforma e ka përmbysur këtë trend, pasi i janë shtuar shtatë milionë përdorues të rinj, disa herë më shumë sesa e kanë parashikuar analistët. "Viti 2022 ka qenë i vështirë, me një fillim të vrazhdë, por përfundim të ndritshëm", ka thënë kompania përmes një deklarate.

Largimi i Hastingut e lë "Netflix"-in në një treg të ngarkuar, mirëpo me 231 milionë shikues në gjithë botën. Kompania tani do të drejtohet nga Ted Sarandos dhe Greg Peters, të dy në pozita të larta ekzekutive.



## Alphabet", kompania amë e "Google"-s, shkurton 12 mijë vende pune



Nju-Jork, 20 janar - "Alphabet", kompania amë e gjigantit "Google", do të shkurtojë 12 000 vende të punës. Shefi i kompanisë, Sundar Pichai, ka thënë në një email të brendshëm se ai merr "përgjegjësi të plotë" për shkurtimin e vendeve të punës.

Ky vendim do të prekë 6 për qind të fuqisë punëtore të kompanisë "Alphabet" dhe kryesisht ekipet e angazhuara në rekrutim dhe inxhinieri.

Ky lajm vjen pasi "Microsoft"-i ka bërë me dije se do të shkurtojë 10 000 vende të punës. "Amazoni" ka bërë njoftim të ngjashëm ditë më parë - do të ketë 18 000 vende të punës më pak.

Pichai ka falënderuar stafin "për punën e madhe" në rolet e tyre dhe ka shtuar se kontributet e tyre do të jenë shumë të çmueshme. "Teksa ky tranzicion nuk do të jetë i lehtë, ne do t'i mbështetim punëtorët që janë në kërkim e sipër të mundësive të reja". "Deri atëherë, ju lutem kujdesuni për veten teksa pranoni këtë lajm të vështirë. Nëse po e nisni punën tani, jeni të lirë që të punoni nga shtëpia sot".

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Emisarët, pas takimit me Kurtin: Kemi pritur më shumë mirëkuptim për propozimin e BE-së

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajčak, ka thënë të premten në Prishtinë se ka pritur më shumë mirëkuptim për mundësitë që i ofron propozimi i BE-së për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Lajčaku, i shoqëruar edhe nga i dërguari i posaçëm amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe këshilltari i presidentit francez Emannuel Macron dhe nga ai i kancelarit gjerman Olaf Scholz, zhvilloi një takim më shumë se dy orësh me kryeministrin Kurti në kuadër të përpjekjeve për t'i nxitur bisedimet Kosovë - Serbi për normalizimin e marrëdhënieve



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 20 janar - Pas takimit me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajčak, në një deklaratë para medieve në Prishtinë, ka thënë se delegacioni i emisarëve ndërkombëtarë ka pritur më shumë mirëkuptim rreth mundësive që ofron propozimi për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Lajçaku ka thënë të premten se qëllimi i takimit me kryeministrin Kurti ishte diskutimi për propozimin për normalizim, të cilin, siç ka thënë ai, i kishin prezantuar Kurtit në shtator, si dhe më vonë në muajin dhjetor [të vitit të kaluar]. "Është shumë herët për të bërë deklarata dramatike sepse, siç e dini, ne jemi në mesin e misionit tonë dhe do të vazhdojmë për në Beograd, kështu që nuk kam shumë çfarë të them. Por, dua të them se, megjithatë, në këtë pikë, ne kemi pritur që të kuptohen më mirë mundësitë që i ofron ky propozim. Shpresoj të mbërrijmë atje, te mirëkuptimi i plotë, si dhe shfrytëzimi i plotë i potencialit që ka ky propozim. Ne do të vazhdojmë të punojmë në këtë", ka thënë Lajčak.

Në takim me kryeministrin Kurti, përveç Lajçakut, morën pjesë emisari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, i dërguari i posaçëm i Francës, Emmanuel Bonne, ai i Gjermanisë, Jens Plotner, dhe Francesco Talon, këshilltar i kryeministres së Italisë.

Lajçaku ka theksuar se Bashkimi Evropian dhe ShBA-ja janë të përkushtuar për arritjen e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe këtë, sipas tij, e dëshmon prania e emisarëve të ShBA-së, të Gjermanisë, të Italisë dhe të Francës në takim.

Emisarët ndërkombëtarë qëndruan të premten në Prishtinë me qëllim të shtimit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pas vizitës në Prishtinë, ata do të shkojnë në Beograd, ku do të takohen me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Vizitat në të dyja vendet synojnë ta përgatitin terrenin për vazhdimin e dialogut në nivel të lartë në Bruksel. Propozimi i BE-së apo plani franko-gjerman iu dorëzua autoriteteve në Prishtinë dhe Beograd në fund të verës dhe mbështetet nga Franca, Gjermania dhe ShBA-ja.

Zyrtarët në Prishtinë kanë thënë se ky propozim paraqet një bazë të mirë për ta vazhduar dialogun me Serbinë, ndërsa ata në Beograd kanë thënë se nuk është i favorshëm për ta.

Plani plani franko-gjerman parasheh të drejta të barabarta për Kosovën dhe Serbinë, respektim të integritetit territorial, paprekshmëri të kufijve, njohje të simboleve shtetërore dhe një aranzhim të veçantë për komunitetin serb në Kosovë.

Në dokument nuk përmendet njohja e ndërsjellë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë apo anëtarësimi i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara - për të cilat gjëra insistojnë publikisht zyrtarët kosovarë, por theksohet mbështetja që palët duhet t'i japin njëra-tjetrës në procesin e integrimeve evropiane.

Nga Serbia, po ashtu, kërkohet që të mos e pengojë anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Propozimi i ka dhjetë pika dhe nëse palët pajtohen me të, ai do të hapë rrugën për vazhdimin e dialogut drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, ligjërisht obliguese.

Sipas propozimit, palët do të zhvillonin marrëdhënie të mira fqinjësore mes vete, duke u bazuar në të drejtat e barabarta, si dhe do t'i njihnin simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë pasaportat, targat e veturave, diplomat dhe vulat doganore.

Të gjitha mospajtimet, sipas këtij propozimi, Kosova dhe Serbia do t'i zgjidhnin me mjete paqësore, duke u përmbajtur nga kërcënimet apo përdorimi i forcës.

# Chollet: Marrëveshja përfundimtare do të kërkojë zgjidhje të vështira dhe guxim politik

**Prishtinë, 20 janar -** Këshilltari i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, thotë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë". se marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të kërkojë "zgjedhje të vështira" dhe "guxim politik".

"Të dyja qeveritë duhet të jenë në gjendje të tregojnë gatishmëri për kompromis. Ne mendojmë se këto kompromise janë të mundshme. Ne po përpiqemi të gjejmë zgjidhje kreative për t'i ndihmuar ata që t'i bëjnë ato kompromise", thotë Chollet.

Duke folur një ditë para vizitës së pesë emisarëve ndërkombëtarë në Kosovë, Chollet thotë se ky është një moment i rëndësishëm dhe shfaq shpresën se do të ketë përparim në procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ai thotë se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë duhet të formohet, por thekson se "Asociacioni në formën e Republikës Sërpska është një vijë e kuqe që ShBA-ja s'do ta lejojë".

"Shtetet e Bashkuara nuk do ta pranonin këtë dhe kjo nuk do të ishte diçka që do ta çonim përpara", thotë Chollet.

I pyetur se pas vizitave më të fundit në Kosovë dhe Serbi të emisarëve, a do të jenë të gatshme të dy vendet të pajtohen për ndonjë gjë sa i përket marrëveshjes përfundimtare, Chollet është përgjigjur se do të kërkohen zgjidhje të vështira dhe guxim politik. "Po, kam parë arsye për shpresë në bisedat në Prishtinë dhe në Beograd. Por, kjo do të kërkojë zgjedhje të vështira dhe guxim politik. Dhe, ajo që kam dashur t'ua bëj të qartë liderëve, si në Prishtinë, ashtu edhe në Beograd, ka qenë rëndësia që Shtetet e Bashkuara i kushtojnë këtij procesi, shpresat që i kemi për këtë proces dhe mundësitë potenciale si për Kosovën, ashtu edhe për Serbinë, nëse janë në gjendje të gjejnë një mënyrë për t'i normalizuar marrëdhëniet. Mendojmë se rruga euroatlantike për Kosovën dhe për Serbinë ekziston. Dhe ne duam t'i shohim ato duke ecur në atë rrugë. Por, do të jetë e vështirë, për aq kohë sa kjo çështje mbetet e pazgjidhur. Dhe kjo është arsyeja përse do të bëjmë gjithçka që mundemi për ta promovuar këtë ecje përpara", ka deklaruar Chollet.

Duke komentuar vendimin e fundit të Qeverisë së Kosovës për moslejimin e qarkullimit të automjeteve me targa ilegale serbe, KM, të regjistruara në dhjetor e këndej, Chollet thotë se ky "është pikërisht ai lloj hapi që ShBA-ja nuk ka dashur ta shohë".





DËMET DHE PASOJAT E SHKAKTUARA NGA RESHJET E SHIUT NË DISA KOMUNA TË KOSOVËS JANË JASHTËZAKONISHT TË MËDHA

# Nis vlerësimi i dëmeve pas vërshimeve

Në disa komuna të Kosovës janë krijuar komisione për t'i vlerësuar dëmet e shkaktuara nga vërshimet ditët e fundit. Si pasojë e shirave të rrëmbyeshëm, vërshimet kanë prekur më së shumti komunën Skenderaj, Mitrovicë e Jugut, Klinë dhe Istog, duke dëmtuar ekonomi familjare, biznese, kultura bujqësore dhe infrastrukturën rrugore. Qytetarët, ekonomitë familjare dhe bizneset, përveç humbjes dhe dëmtimit të pronave të tyre, po ballafaqohen edhe me mungesë të ujit të pijshëm dhe të energjisë elektrike

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

**Prishtinë, 20 janar -** Si pasojë e shirave të rrëmbyeshëm, vërshimet kanë prekur më së shumti komunën Skenderaj, Mitrovicë e Jugut, Klinë dhe Istog, duke dëmtuar ekonomi familjare, biznese, kultura bujqësore dhe infrastrukturën rrugore.

Vërshimet kanë prekur edhe komunën Podujevë, Gjakovë dhe Pejë.

Duke iu përgjigjur situatës së krijuar pas të reshurave të pandërprera, që kanë shkaktuar vërshime dhe dëme të konsiderueshme materiale, kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe nënkryetari Sami Lushtaku, në takimin me Bordin e Drejtorëve, kanë marrë vendim që të themelojnë 11 komisione komunale me nga 5 anëtarë secili, të cilët menjëherë do të dalin në terren për ta bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara. Pas vërshimeve nga reshjet e dendura të shiut, të enjten janë evakuuar rreth 120 familje në komunën e Skenderajt.

Kjo komunë ka njoftuar se nuk do të ketë orar të punës për ekzekutivin komunal deri në përfundimin e procesit të vlerësimit të tërësishëm të dëmeve materiale. "Në këtë kuadër kërkohet nga qytetarët që t'i ruajnë provat (video-xhirim, fotografi) të dëmeve të pronave të luajtshme dhe të paluajtshme", ka njoftuar komuna e Skenderajt.

Qendra Operative Emergjente Lokale për Menaxhimin e Vërshimeve, e udhëhequr nga kryetari i komunës, Bedri Hamza, ka mbajtur mbledhje të premten për ta vlerësuar situatën emergjente të shkaktuar nga vërshimet ditën e djeshme.

Lidhur me menaxhimin e situatës, kryetari i komunës, Bedri Hamza, fillimisht ka falënderuar për angazhim të gjithë aktorët relevantë duke përmendur policinë e kosovës, zjarrfikësit, ndërmarrjet të cilat operojnë në komunën e Mitrovicës, FSK-në, Kryqin e Kuq dhe falënderim të veçantë edhe për Klubin e Zhytësve.

Në këtë takim Hamza bëri një rezyme të përgjithshme sa i përket menaxhimit të situatës aktuale pas vërshimeve, ku theksoi se dje patëm një situatë emergjente, të paparë ndonjëherë në Mitrovicë. "Më shumë se 40 familje janë evakuuar







në gjithë qytetin dhe pasojat janë shumë të mëdha. Mbi të gjitha, fatmirësisht, nuk kemi pasur humbje të njerëzve. Ata kanë nevojë për gjithçka, pasi që shtëpitë janë të pabanueshme dhe urgjent duhet të qëndrojmë pranë njerëzve me pako ushqimore, veshmbathje, si dhe duhet të bëhet identifikimi i familjeve që janë pa strehë, t'i vendosim me qira dhe komuna ta marrë përsipër pagesën e qirasë", ka thënë Hamza.

Me këtë rast, Hamza ka kërkuar nga drejtoresha për Buxhet dhe Financa, Igballe Islami, t'i kryejë të gjitha veprimet e nevojshme që buxheti të jetë operacional dhe të jenë në dispozicion mjetet të cilat do të shërbejnë për t'u dalë në ndihmë qytetarëve.

Kryetari i komunës së Klinës, Zenun Elezaj, bashkë me bashkëpunëtorë të komunës, ka vizituar të premten shumë vende për të parë nga afër gjendjen e krijuar nga vërshimet si pasojë e reshjeve të shumta. Në disa pjesë të qytetit dhe në shumë fshatra gjendja është e rëndë dhe ka dëmtime në infrastrukturë rrugore dhe në shtëpi apo biznese private. Pra, dëmi është i konsiderueshëm. "Ne menjëherë do ta formojmë komisionin për vlerësim të dëmeve dhe brenda mundësive buxhetore do t'i ndihmojmë qytetarët e dëmtuar. Gjithsesi do të kërkojmë ndihmë edhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta ndajë një fond të veçantë që t'u ndihmohet familjeve të dëmtuara, sepse buxheti komunal është i kufizuar", ka thënë Elezaj.

Edhe kryetari i komunës së Istogut, Ilir Ferati, ka thirrur të premten në takim të përbashkët Shtabin Emergjent Komunal, i përbërë nga drejtorë të drejtorive, komandantin e policisë në Istog, FSK-në dhe zjarrfikësit, me të cilët ka diskutuar lidhur me situatën e krijuar në vend si pasojë e reshjeve të shumta të shiut dhe është konstatuar se gjendja aktuale është e menaxhueshme. "Tetë komisione të formuara sot nga ky moment do të dalin në terren që të bëjnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomitë familjare, biznese dhe në bujqësi", ka thënë Ferati.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka njoftuar se situata e përgjithshme hidrometeorologjike në pjesën më të madhe të vendit ditët e fundit është përkeqësuar si pasojë e reshjeve intensive të shiut, sidomos në disa pjesë të vendit. "Reshjet e shiut me intensitet të ndryshuar pritet të vazhdojnë edhe gjatë ditëve në vazhdim (deri më 25/01/2023), të cilat, duke u bazuar në situatën e vështirësuar hidrologjike, ku lumenjtë kanë dalë prej shtretërve të tyre, duke shkaktuar përmbytje. Aktualisht situata më e rënduar është në pjesën perëndimore, veriperëndimore dhe veriore të vendit, por duke pasur parasysh reshjet të cilat janë duke vazhduar aktualisht dhe ditët në vijim, mund të shkaktojnë probleme dhe vështirësi edhe në pjesë të tjera të vendit", ka njoftuar IHK-ja.

Për ta parë gjendjen, në terren ka dalë edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi. Në Skenderaj, bashkë me kryetarin Fadil Nura dhe nënkryetarin Sami Lushtaku, kryetari i PDK-së ka vizituar lokacionet të cilat janë prekur më shumë nga vërshimet dhe përmbytjet e ditës së djeshme. "Fatkeqësisht, dëmet janë të mëdha. Fatmirësisht, humbje në njerëz nuk ka. Prandaj, kryetarin Nura dhe të gjithë zyrtarët komunalë i përgëzova për reagim efikas dhe dinjitoz, brenda mundësive dhe kapaciteteve të tyre por, mbi të gjitha, që në këtë ditë të vështirë mobilizoi dhe bashkoi të gjithë qytetarët në ndihmë të njëri-tjetrit. Duke qëndruar pranë secilit qytetar të Skenderajt në këto momente sfide për ta, thirrja jonë emergjente shkon edhe një herë për Qeverinë e Republikës së Kosovës", ka thënë Krasniqi.

Ai ka theksuar se gjendja është e rëndë, me dëme të mëdha materiale dhe infrastrukturë të bllokuar publike. "Prandaj, reagimi i nivelit qendror duhet të jetë konform situatës emergjente, me të gjitha kapacitetet shtetërore, përfshirë krijimin e një pakoje financiare për kompensimin e të gjitha dëmeve që kanë pësuar qytetarët. Uroj që sa më parë situata t'i rikthehet normalitetit dhe banorët e Skenderajt të rikthehen në shtëpitë e tyre!", ka shkruar Krasniqi.

Ndërkaq lideri i AAK-së i ka bërë thirrje qeverisë që në këtë situatë t'u gjendet pranë komunave që kanë pësuar nga vërshimet. "Me shqetësim po e përcjell situatën e krijuar pas përmbytjeve dhe vërshimeve në Rrafshin e Dukagjinit, Skenderaj e Mitrovicë, ku dëmet kanë përfshirë infrastrukturën e tokat bujqësore. Apelojmë tek institucionet qendrore në Prishtinë për ngritjen e gatishmërisë për t'u qëndruar afër autoriteteve komunale dhe qytetarëve të prekur nga kjo fatkeqësi natyrore", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

# Kurti: Qeveria qëndron pranë banorëve të komunave ku pati vërshime

Kryeministri i vendit, Albin Kurti, bashkë me ministrin e Mbrojtjes, Armend Mehaj dhe atë të Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, kanë vizituar të premten komunën e Istogut dhe Klinës. "Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të gjitha institucionet shtetërore qëndrojnë pranë banorëve të komunave ku pati vërshime duke i ndihmuar e mbështetur ata. Dëmtimi i brigjeve dhe shtretërve të lumenjve nga eksploatimi i egër i zhavorrit, prerja ilegale e pyjeve ndër vite dhe mungesa e projekteve të pyllëzimit, sistemet joadekuate të kanalizimit dhe ujëmbledhjes, si dhe ndryshimet klimatike globale i kanë lehtësuar, shpejtuar e shpeshtuar përmbytjet e vendbanimeve nga vërshimet", ka thënë Kurti.

Kurti ka vizituar edhe Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Istog, ku ka takuar dy familje të evakuuara nga Zallqi. "Përveç dëmeve të konsiderueshme materiale, nuk kemi qytetarë të vdekur e as të lënduar", ka deklaruar Kurti.

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka theksuar se angazhimi i FSK-së është në nivelin më të lartë. "Njësitet tona specialistike të kërkim-shpëtimit kanë qenë në terren gjatë gjithë kohës për ta ofruar mbështetjen e tyre. Angazhimi i FSK-së është në nivelin më të lartë dhe në bashkëpunim me autoritetet lokale situata është duke u menaxhuar mirë. Niveli i ujit ka rënë edhe në këto dy qytete dhe gjendja është duke u normalizuar", ka thënë Mehaj.





## LDK-ja për paralajmërimet për atentat: Të bëhen hetime të pavarura



**Prishtinë, 20 janar -** Lidhja Demokratike e Kosovës ka falënderuar qytetarët e Kosovës në përgjithësi dhe anëtarësinë e saj në veçanti për përkrahjen dhe qetësinë e treguar deri më tani lidhur me informimin për planifikimin e atentateve ndaj kryetarit të saj, Lumir Abdixhiku, dhe tre deputetëve të LDK-së.
Po ashtu LDK-ja ka falënderuar partnerët ndërkombëtarë për mbështetjen e dhënë lidhur me këtë rast. "LDK-ja u bën thirrje organeve kompetente që, në përputhshmëri me seriozitetin e situatës, në të cilën cak potencial janë katër përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, të zhvillojnë hetime të pavarura dhe të ruajnë profesionalizmin, si dhe diskrecionin lidhur me këtë proces hetimor", është thënë në komunikatën e LDK-së.

# Nis punën grupi punues për vetingun

**Prishtinë, 20 janar -** Në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë të premten është mbajtur takimi i parë njoftues i grupit punues për hartimin dhe finalizimin e projektligjeve për realizimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë si dhe ofrimin e mbështetjes për Komisionin Ad hoc të Kuvendit për Zhvillimin e Procesit të Vlerësimit Kalimtar.
Ministrja Haxhiu e cila ishte pjesë e takimit, fillimisht falënderoi të pranishmit për kontributin e deritanishëm, duke vlerësuar edhe njëherë si të rëndësishëm zhvillimin këtij procesi reformues në drejtësi dhe përmbylljen e tij në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe standardet tjera kushtetuese dhe ndërkombëtare.
Mes tjerash, ministrja Haxhiu edhe njëherë ritheksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe kontributit profesional të të gjithë akterëve në këtë proces, atyre vendor dhe ndërkombëtar dhe njëkohësisht shprehu keqardhjen për mungesën e akterëve të sistemit të drejtësisë në një takim kaq të rëndësishëm për vet sistemin e drejtësisë.
Përfaqësues të shoqërisë civile dhe partnerë ndërkombëtarë, ritheksuan rëndësinë e procesit, zhvillimit të tij në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe gjithashtu ofruan mbështetjen e tyre në zhvillimin dhe përmbylljen e këtij procesi. Të pranishëm në takim ishin gjithashtu përfaqësues institucional, përfaqësues të shoqërisë civile dhe partnerë zhvillimorë ndërkombëtar.



# Drejtoresha e ShSKUK-së viziton ambulancat specialistike në spitalin e Mitrovicës



**Prishtinë, 20 janar -** Ushtruesja e detyrës së drejtorit të përgjithshëm e Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, Pranvera Zejnullahu-Raçi, ka vizituar ambulancat specialistike të Spitalit të Mitrovicës, të cilat pas reshjeve të vazhdueshme të shiut, janë përfshirë nga uji.
Këto ambulanca specialistike funksionojnë në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mitrovicë.
Në takim me drejtoreshën e Spitalit, Luljeta Buçinca-Zhubi, ajo është njoftuar se ditën e djeshme, pas reshjeve të pandalshme të shiut, meqë ambulancat ndodhen në bodrumin e Qendrës së Mjekësisë Familjare, janë vërshuar nga uji.
U.d. drejtoresha Zejnullahi-Raçi, ofroi mbështetje të plotë nga ShSKUK për ta tejkaluar sa më parë këtë situatë. Aktualisht, po punohet nga shërbimet përkatëse që po largojnë ujin.
Shërbimet shëndetësore ambulantore ortopedike janë ofruar në objektin e Spitalit të Mitrovicës, përderisa Reparti i Pediatrisë që vepron në kuadër të QKMF-së, po vazhdon të ofrojë shërbime mjekësore. Në objektin e Spitalit ku ndodhen repartet e tjera nuk ka pasur telashe pas vërshimeve.

## Shtohen aktivitetet e policisë në Prizren për ngritjen e sigurisë në komunikacion

**Prizren, 20 janar -** Në kuadër të aktiviteteve parandaluese dhe ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor Njësit patrulluese të Njësisë Rajonale të Komunikacionit Rrugor e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren, në këtë fillim vit kanë shtuar aktivitet e tyre. Gjatë kësaj kohe njësit policore kanë patrulluar pa ndalë në zonën e tyre të përgjegjësisë, janë mbajtur shumë pika kontrolli dhe për kundërvajtësit janë shqiptuar gjoba. "Gjatë kësaj kohe, pra nga 1 janar 2023 deri më 18 janar 2023 nga njësit patrulluese te Njësisë Rajonale të komunikacionit Rrugor në Prizren, kanë shqiptuar 1 257 gjoba të trafikut. Janë konfiskuar 11 patentëshoferë dhe 5 ngasësve u është vazhduar masa e konfiskimit të patentëshoferëve. Ju informojmë se me qëllim të ngritjes së sigurisë në trafik, Njësisë Rajonale e komunikacionit Rrugor në Prizren nga data 18.01.2023 është pajisur edhe me tablet, të cilët do të jenë të kyçur online në data bazat policore dhe do të përdoren nga patrullat në terren për verifikimin e dokumenteve, personave dhe automjeteve", ka njoftuar Policia e Kosovës.



## Haradinaj pret në takim Walkerin, i jep medaljen "Me besim në zot, atdhe e shtet"

**Prishtinë, 20 janar -** Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka pritur të premten në takim ambasadorin William Walker. "Sot kishim nderin ta kemi në vizitë z. William Walker, me të cilin evokuam kujtime nga e kaluara, njëkohësisht zhvilluam bisedë miqësore për zhvillimet aktuale në vend", ka theksuar Haradinaj.

Ai ka shtuar se ambasadori William Walker mbetet heroi i së vërtetës për krimet serbe në Kosovë. "Njeriu i cili me cilësimin e masakrës së Reçakut si krim kundër njerëzimit zgjoi ndërgjegjen e botës për krimet serbe në Kosovë. Fjalët e tij për masakrën e Reçakut u bënë pikë kthese në sensibilizimin e opinionit dhe aktorëve kryesorë ndërkombëtarë për nevojën e intervenimit në mënyrë që të ndalej gjenocidi dhe spastrimi etnik kundër popullsisë civil", ka deklaruar lideri i AAK-së.

Haradinaj me këtë rast ambasadorit Walker i ka dhënë medaljen "Me besim në zot, atdhe e shtet", për kontributin e tij në çështjen kombëtare. "Mikun e madh të shqiptarëve e falënderova edhe njëherë për gjithçka që ka bërë për Kosovën", është shprehur Haradinaj.



# Digjitalizohet procesi i raportimit dhe monitorimit të reformave të administratës publike



**Prishtinë, 20 janar -** Një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës janë reformat e administratës publike, duke përfshirë modernizimin dhe digjitalizimin e sektorit. MPB-ja ka njoftuar se Qeveria e Kosovës angazhohet për të modernizuar dhe forcuar administratën publike në mënyrë që qytetarët e vendit të shërbehen siç duhet dhe efektivisht nga institucionet publike. Muajin e kaluar qeveria ka miratuar strategjinë e re për reformat e administratës publike 2022-2027 dhe planin e veprimit 2022-2024. "Strategjia e re paraqet një vizion të ri të qeverisë për administratën publike, që ka në qendër qytetarin dhe, ndër të tjera, fokusohet në digjitalizim, forcimin e llogaridhënies menaxheriale, përmirësimin e shërbimeve publike, si dhe uljen e barrës administrative", ka njoftuar MPB-ja.

Për ta siguruar zbatimin efektiv të reformave të planifikuara të qeverisë, Ministria e Punëve të Brendshme ka finalizuar punën për digjitalizimin e monitorimit dhe raportimit për zbatimin e veprimeve reformuese nga njësitë përgjegjëse të qeverisë. "Kjo do t'i përmirësojë kapacitetet e qeverisë për t'i zbatuar masat e planifikuara reformuese në mënyrë efektive dhe do ta rrisë përgjegjshmërinë dhe transparencën e zbatimit të reformave të administratës publike. Platforma e re digjitalizon një proces të raportimit dhe mbledhjes së të dhënave nga njësitë përgjegjëse për zbatimin e masave reformuese, i cili kryesisht bëhej manualisht më parë, gjë që ka ndikuar në cilësinë e të dhënave dhe të raporteve të monitorimit për zbatimin e reformave të administratës publike. Platforma e re i mundëson qeverisë ta koordinojë më mirë zbatimin e planit të veprimit për reformimin e administratës publike dhe ta rrisë llogaridhënien dhe përgjegjësinë institucionale. Platforma e re digjitale për monitorimin dhe raportimin e reformave në administratën publike do të menaxhohet nga Departamenti për Reformat e Administratës Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme", ka njoftuar MPB-ja.

## Konjufca priti në takim gazetarët ukrainas të strehuar në Kosovë

**Prishtinë, 20 janar -** Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur në takim gazetarët nga Ukraina, të strehuar në Kosovë, në kuadër të programit "Gazetarët në Rezidencë", i iniciuar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Qendra Evropiane për Liri të Shtypit dhe Medias, si dhe mbështetur dhe financuar nga Qeveria e Kosovës.

Në takimin e përzemërt, Konjufca ka theksuar se populli i Kosovës qëndron përkrah popullit të Ukrainës në këto kohë të vështira, edhe atëherë kur paqja dhe liria sërish do të ngadhënjejnë atje. Ai vuri në pah se Republika e Kosovës i është bashkuar botës humane e demokratike duke e dënuar agresionin e Federatës Ruse ndaj Ukrainës dhe i është përgjigjur edhe me sanksione këtij agresioni të paprovokuar. "Jeni çdoherë të mirëpritur në shtetin tonë dhe ndihuni si në shtëpinë tuaj", u shpreh Konjufca.

Ndërkaq gazetarët e Ukrainës e falënderuan për pritjen Konjufcën dhe shprehën mirënjohjen e tyre për mikpritjen e ngrohtë dhe mbështetjen që ua ka ofruar populli dhe Republika e Kosovës.



## Kapen barna të kontrabanduara

**Prishtinë 20 janar -** Njësitë e Doganës kanë realizuar një aksion në qytetin e Ferizajt dhe kanë arritur të gjejnë medikamente të kontrabanduara në vlerë rreth 5 000.00 euro. Për herë të parë që nga lansimi i sistemeve elektronike (respektivisht e-Dogana) Dogana ka pranuar informacion nga qytetarët e përgjegjshëm lidhur me parregullsitë potenciale.
Zyrtarët doganorë, bazuar në informatat e pranuara përmes aplikacionit e-Dogana për raportimin e parregullsive, kanë organizuar një kontroll në një barnatore në Ferizaj dhe në këtë rast është hasur në mallra të kontrabanduar në vlerë rreth 5 000.00 euro. Në këtë lokacion është gjetur edhe një bunker i ndërtuar për fshehjen e mallrave të kontrabanduara. Mallrat janë sekuestruar dhe ndaj palës janë iniciuar procedurat kundërvajtëse.
Dogana e Kosovës ka falënderuar dhe inkurajuar qytetarët që të bashkëpunojnë dhe të raportojnë të gjitha parregullsitë që lidhen me veprimtarinë e Doganës përmes aplikacionit e-Dogana.
Dogana e Kosovës ka aplikacionin e-Dogana për pajisjet e mençura android dhe ios, i cili mundëson lajmërim të parregullsive dhe sjelljeve joprofesionale me komunikim të sigurt dhe ofron shërbime të tjera me qëllim të shërbimit ndaj qytetarëve dhe komunitetit të prodhuesve dhe tregtisë në përgjithësi.



# ASK-ja nis takimet konsultative me përfaqësuesit e komunave për regjistrimin e popullsisë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**



**Prishtinë, 20 janar -** Që nga fillimi i muajit janar Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) është duke zhvilluar takimet konsultative me udhëheqësit e komunave e përfaqësues të institucioneve lokale në Republikën e Kosovës lidhur me organizimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të regjistrimit të popullsisë.
Takimet konsultative do të mbahen përgjatë tërë periudhës kohore janar 2023, për të vazhduar më pas me takimet e rregullta periodike. Këto takime vijnë pas konsultimeve ndërinstitucionale që janë zhvilluar gjatë muajit dhjetor të vitit të kaluar me të gjitha institucionet qendrore në vend.
Të premten përfaqësuesit nga ASK-ja janë takuar me kryetarin e komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj. Ky i fundit ka njoftuar për rrjedhën e takimit. "Regjistrimi do të jetë gjithëpërfshirës dhe të gjithë qytetarët e Kosovës janë të obliguar ligjërisht që t'i përgjigjen regjistrimit dhe të japin informata të sakta për çdo anëtar të familjes. Komuna e Deçanit do ta zbatojë në tërësi vendimin e Komisionit Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, duke e formuar komisionin komunal për realizimin e këtij regjistrimi, i cili do t'i zbatojë në tërësi përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara, si dhe do të përdoren të gjitha kapacitetet që kemi si komunë për regjistrimin e plotë të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave. Andaj ne si komunë jemi të gatshëm ta ofrojmë të gjithë mbështetjen dhe të gjithë mekanizmat e nevojshëm për realizimin e këtij projekti", ka theksuar Ramosaj.
ASK-ja ka njoftuar se qëllim i takimeve konsultative është njohja me procesin e regjistrimit, si dhe rolin, detyrat e përgjegjësitë që ka secila komunë në procesin e regjistrimit. Gjatë takimeve të gjithë zyrtarët e komunave kanë shprehur gatishmërinë për bashkëpunim dhe bashkërendim të aktiviteteve për një regjistrimin gjithëpërfshirës dhe kualitativ.
Bazuar në Ligjin për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë nr. 08/L-114, roli dhe përgjegjësitë e komunave në Kosovë përcaktohen në kuadër të Komisionit Komunal të Regjistrimit (KKR), i cili formohet në secilën komunë. KKR-ja përfaqëson strukturën etnike të popullsisë, duke marrë në konsideratë edhe dispozitat ligjore për përfaqësimin e komuniteteve joshumicë.
Zbatimi i të gjitha masave normative dhe delegimi i përgjegjësive në kohë ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë dhe saktësinë e të gjitha aktiviteteve operacionale të projektit nacional të Regjistrimit të Popullsisë 2023.
Përfaqësuesit e ASK-së kanë theksuar se dialogu me përfaqësues të nivelit lokal, kryetarë komunash, e përfaqësues të institucioneve lokale në Republikën e Kosovës, lidhur me organizimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të regjistrimit të popullsisë, është pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit ndërinstitucional.

## Gjendje alarmante në kanalin e Ibër Lepencit, çrregullime me ujë të pijshëm

**Prishtinë, 20 janar -** Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka njoftuar se si shkak i reshjeve të dendura atmosferike në afërsi dhe rreth liqenit të Ujmanit ka ngritje të turbullirës së ujit në kanalin e Ibrit Lepencit.
Sipas një njoftimi për medie, bëhet me dije se impianti i trajtimit të ujit në Shkabaj dhe Drenas nuk kanë mundësi teknike ta trajtojnë ujin për pije. "Të nderuar konsumatorë, ju njoftojmë se për shkak të reshjeve të dendura atmosferike në afërsi dhe rreth liqenit të Ujmanit kemi ngritje të turbullirës së ujit në kanalin e Ibrit Lepencit. Impianti i Trajtimit të Ujit në Shkabaj dhe ai në Drenas nuk kanë mundësi teknike ta trajtojnë ujin për pije", thuhet në njoftim.
Gjithashtu, sipas njoftimit, për shkak të gjendjes alarmante me vërshime dhe turbullirë të ujit në kanalin e Ibër Lepencit, çrregullime në sistemin e furnizimit me ujë do të ketë në disa vende. "Për shkak të gjendjes alarmante me vërshime dhe turbullirës së ujit në kanalin e Ibër Lepencit, përveç Fushë-Kosovës, Drenasit, Zonës Industriale dhe lagjes Kalabria në Prishtinë, çrregullime në sistemin e furnizimit me ujë sot do të kenë edhe: lagjja 'Kodra e Trimave' dhe të gjitha zonat që furnizohen me ujë nga rezervuari i Mirditës si: lagjja e Muhaxhirëve, lagjja Dodona, Taslixhe, Aktash, Bregu i Diellit dhe të gjitha zonat e Matit", thuhet në njoftim.
Më tutje, në njoftimin e KRU "Prishtina" thuhet se një situatë e tillë vazhdon deri në përmirësimin e situatës me turbullirë në kanal. "Mbeteni të njoftuar, deri në vendimin e radhës, varësisht nga situata me vërshime dhe reshje atmosferike", thuhet në njoftimin e KRU "Prishtina".



# Mbi 13.000 lobistë: Çfarë po ndodh në Bashkimin Evropian?



Nga Andrea MURATORE

Nëntëmbëdhjetë lobues për çdo eurodeputet: Brukseli është një udhëkryq për palët e interesuara nga kompanitë, grupet e presionit dhe kompanitë financiare. Janë mbi 13 mijë lobistët e regjistruar në regjistrin zyrtar të Bashkimit Evropian, ose 19 herë më shumë sesa numrit të përgjithshëm të deputetëve të Parlamentit Evropian, 705.

Nga ky këndvështrim, skandali "Panzeri–Kaili" rrezikon të hedhë një hije të rëndë mbi punën e profesionistëve të marrëdhënieve me publikun, të cilët janë në mënyrë legjitime palë të interesuara. Më shumë se sa lobim, nëse vërtetohen akuzat për skandalin në fjalë, do të detyrohemi të flasim për një histori të trishtë korrupsioni dhe degradimi moral, siç e nënvizoi edhe Komisioneri për Çështjet Ekonomike në BE, Paolo Xhentiloni.

Por skandali rrezikon të dëmtojë imazhin e gjithë këtij sektori, brenda të cilit – përveç Panzerit – ka edhe ish-eksponentë të shumtë të institucioneve. E përditshmja italiane "Corriere della Sera" kujton se deri 485 ish-deputetë punojnë për grupime të ndryshme interesi.

Ndërkohë shumë figura të niveleve të larta drejtuese mbajnë sot poste të rëndësishme tek shumëkombëshet e mëdha. Hoze Manuel Barroso, ish-president i Komisionit Evropian, ka qenë një menaxher i nivelit të lartë në bankën amerikane "Goldman Sachs".

Ish-deputeti dhe zëvendëskryeministri britanik Nik Kleg është që nga viti 2018 zëvendës/president i Facebook. Dhe ka edhe shumë raste të lobingjeve në organet administrative që merren me paditë apo proceset vendimmarrëse. Për shembull vitin e kaluar, Nik Banaseviç, një tjetër zyrtar i lartë i përfshirë në një padi kundër Google dhe Microsoft, u largua nga BE për t'iu bashkuar "Gibson Dunn", një studio e njohur ligjore.

Sipas dosjes "Uber Files", ish-komisioneri holandez Neli Kros, dyshohet se përfaqësonte kompaninë private të transportit në fazën 18-mujore midis fundit të mandatit të tij dhe kufirit ligjor të shënuar nga Komisioni Evropian për të marrë një rol në sektorin privat.

Britanikja "Financial Times", raporton se ky problem është trajtuar vetëm në frontin e konsulencës: "Brukseli po i kufizon mundësitë për zyrtarët e BE-së që punojnë për kompanitë e sektorit privat, nëpërmjet shfrytëzimit të lobimeve midis institucionit dhe studiove ligjore apo kompanive të këshillimit".

Por në përgjithësi bota e lobimit nuk ka rregulla të përcaktuara dhe krahas profesionistëve transparentë, kjo krijon një botë të ndërmjetme palësh të interesuara, e cila ekziston paralelisht me forcimin e agjencive dhe aparateve, si dhe me vendimet strategjike të marra nga BE.

Ata që punojnë në Bruksel kujtojnë zhurmën e seancave dëgjimore që u zhvilluan në kohën e diskutimeve mbi Këshilli Evropian i Industrisë Kimike (GDPR), kur kompanitë e mëdha të teknologjisë ishin më kritiket ndaj rregulloreve evropiane. Këshilli Evropian i Industrisë Kimike është sot investitori kryesor në lobim në Komisionin Evropian me 9 milionë euro, i ndjekur nga Google me 6 dhe Microsoft me 5.

Facebook dhe ExxonMobil lobojnë secila me 3 milionë euro. Muhamed Shahim, eurodeputet socialist, nënvizoi se si në qershor lobimi i prodhuesve të mëdhenj të automjeteve ishte intensifikuar për të ndaluar opsionin e kalimit në energji elektrike deri në vitin 2035.

Dhe së fundi, siç vëren POLITICO, shumë deputetë besojnë se ai "mashtroi ligjvënësit evropianë gjatë negociatave për 2 ligjet e rëndësishme të teknologjisë së BE-së, Aktin e Tregjeve Dixhitale (DMA) dhe Aktin e Shërbimeve Dixhitale (DSA), duke u fshehur pas organizatave të tjera: lobe që supozohet se përfaqësojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilave u dhanë fonde".

Ndërkohë, lobet pretendonin se ishin përfaqësues zyrtarë të SME-ve, duke promovuar dhe mbrojtur interesat tregtare të Big Tech, pa bërë të ditur lidhjet e tyre. Pra një shembull tjetër i faktit që problemi nuk është lobimi në vetvete por mungesa e një rregullimi vertikal në këtë sektor dhe rreziqet gjatë periudhave kalimtare, të cilat për momentin, kanë të bëjnë vetëm me 9 agjenci të BE-së.

Rregullat për konfliktin e interesit ekzistojnë, dhe do të mjaftonte vetëm zbatimi i tyre. Por edhe dallimi i profesionistëve të çështjeve institucionale nga amatorët që përfitojnë nga kontakti i drejtpërdrejtë ndërmjet përfaqësuesve institucionalë dhe sektorit privat. / *"Il Giornale" – Bota.al*




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Derbi i 'zjarrtë' në mes të Pejës dhe Trepçës




**Prishtinë, 20 janar -** Java e 19 në Prince Caffe Superligën e Kosovës në basketboll do të dhurojë disa ndeshje interesante, kurse sfida kryesore do të zhvillohet ndërmjet Pejës dhe Trepçës. Dy skuadra me traditë në basketbollin e Kosovës synojnë titullin e kampionit, duke e bërë këtë ndeshje edhe më të rëndësishme. Pejanët këtë edicion kanë 13 fitore e pesë humbje, kurse mitrovicasit nëntë fitore e nëntë humbje. Në dy takimet mes këtyre skuadrave fitore shënuan verdhezinjtë. Takimi i parë i kësaj xhiroje zhvillohet ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Bashkimit. Prishtinasit kanë fituar Superkupën, ndërsa mjaft mirë qëndrojnë edhe në elitë me 13 fitore e pesë humbje, kurse prizrenasit kanë pasur ngritje të formës, duke numëruar tetë fitore e dhjetë humbje. Rahoveci, që ndodhet në vendin e fundit me dy fitore e 16 humbje, do te ndeshet me Ponte Prizrenin, që ka gjashtë fitore e 12 humbje, për të bërë këtë sfidë shumë të rëndësishme për 'fatin' e këtyre dy skuadrave. Java e 19 përmbyllet me përballjen mes Golden Eagle Yllit dhe Vëllaznimit. Kampioni numëron 14 fitore radhazi dhe me 32 pikë është lider, kurse kuqezinjtë kanë shtatë fitore e 11 humbje.

**PRINCE CAFFE SUPERLIGA - JAVA 19**

**Të shtunën takohen:**
**17:00 Sigal Prishtina - Bashkimi**
**19:00 Rahoveci - Ponte Prizreni**

**Të dielën takohen:**
**17:00 Peja - Trepça**
**19:00 Golden Eagle Ylli - Vëllaznimi**

# Ministri Çeku: Lajme të mira për futbollin e Kosovës nga FIFA

Prishtinë, 20 janar - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, bashkë me kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Afim Ademi, janë takuar me presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino. Ministri Çeku ka thënë se ka lajme të mira për futbollin e Kosovës nga FIFA. "Në vazhdën e takimeve për sport, në Cyrih të Zvicrës u pritëm nga Gianni Infantino, i pari i FIFA-s. Në takimin e zhvilluar me të, së bashku me presidentin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, diskutuam për zhvillimin e infrastrukturës sonë sportive, konkretisht për planin e përbashkët pesëvjeçar për renovimin e stadiumeve ekzistuese dhe ndërtimin e stadiumeve të reja në vend. Ndërtimi i urave të bashkëpunimit u theksua nga presidenti i FIFA-s, duke shtuar se do të gjejnë rrugë për mbështetje financiare për projektet e tilla madhore që ngritin kapacitetet e sportistëve kosovarë për arritjen e rezultateve kulminante në arenën ndërkombëtare", ka shkruar Çeku në "Facebook".




## SHKURT

### Kampionia e botës, Sophie Sorschag, garon për Kosovën

Garuesja në kërcime me ski, Sophie Sorschag, do të garojë për Kosovën tash e tutje, bërë njoftuar Komiteti Olimpik i Kosovës. Sorschag është kampione e botës me Austrinë në konkurrencë ekipore për vitin 2021. Vitin e kaluar ajo mori pjesë në Lojërat Olimpike në Pekin. "Marrëveshja mes drejtuesve të Federatës Skitare të Kosovës, kryetarit Milaim Kelmendi e nënkryetarit Bujar Turjaka dhe ekipit të Sorschag, u arrit sot në Lubjanë të Sllovenisë", ka njoftuar KOK-u. Në Kosovë garat me kërcime me ski nuk janë fare të zhvilluara. Deri më tani Kosova nuk ka pasur garuese në këtë disiplinë atraktive.

### Shqipëria fiton medalje të artë në ski

Lara Colturi shkruan historinë me Shqipërinë. Italiania ka fituar medaljen e parë të artë në Kampionatin Botëror të Skive Alpine në kategorinë Juniore. Vajza e lindur në Itali, por që mori pasaportën shqiptare, dominoi super-gjigantin ditën e sotme, në St. Anton, Austri, duke i lënë pas me diferencë të ndjeshme kundërshtaret e saj. Pozicioni i dytë dhe medalja e argjendtë shkoi për zviceranen Stefanie Grob. Në podium edhe italiania Alice Calaba, e cila e mbylli garën e treta.

### Ballkani konfirmon largimin e dy futbollistëve

Kampioni i Kosovës në futboll, Ballkani, po vazhdon ndryshime para fillimit të sezonit pranveror. Klubi suharekas ka njoftuar se janë larguar edhe dy futbollistë. Bëhet fjalë për dy futbollistët e huaj, Dejan Zarubica dhe Lucas Cardoso. "Klubi i falënderon për kontributin duke u dëshiruar suksese në vazhdim të karrierës", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

### Ferizaj mposhti Lubotenin në ligën 'Gjergj Kastrioti'

Skuadra e Ferizajt e ka mposhtur Lubotenin në ndeshjen e mbetur nga xhiroja e dytë në ligën e përbashkët në mes të Kosovës dhe Shqipërisë "Gjergj Kastrioti". Për shkak të angazhimit të Lubotenit në garat ndërkombëtare, kjo përballje ishte shtyrë në këtë datë, ndërsa Ferizaj arriti të triumfonte me rezultat 3-1 (20-25, 25-11, 25-19, 25-20) në sete. Të dielën, me fillim nga ora 17:00, në kuadër të xhiros së katërt të këtij kompeticioni, Ferizaj e pret Partizanin në palestrën "Bill Klinton". Në anën tjetër, Luboteni luan si mysafir i Vllaznisë, të shtunën, me fillim nga ora 17:00, në palestrën "Qazim Dervishi".

## Llapi, gati për finalen e Superkupës ndaj Ballkanit

**Belek, 20 janar -** KF Llapi ka mbyllur të premten përgatitjet për ndeshjen e Superkupës së Kosovës në futboll ndaj Ballkanit, e cila zhvillohet sot (e shtunë) në kompleksin "Titanic Belek Futbol Center" në Turqi nga ora 13:00. "Ekipi është në gjendje gatishmërie para këtij dueli të rëndësishëm. Brenda kampit stërvitor dhe grupit të futbollistëve po mbretëron një atmosferë impozante dhe një bashkëpunim tejet korrekt me shtabin teknik. Futbollistët i kanë zbatuar me përpikëri detyrat e dhëna nga trajnerët e ekipit dhe mbetet vetëm angazhim maksimal dhe 'luftë' sportive në fushë për arritjen e qëllimit", thuhet në njoftimin e klubit llapjan.



# Egzon Gjuka e Luna Gonçalves, më të mirët e vitit në hendboll



**Prishtinë, 20 janar -** Federata e Hendbollit e Kosovës ka mbajtur ceremoninë tradicionale "Laureatët e Vitit". Çmimet kryesore i kanë fituar Egzon Gjuka dhe Tainara Luna Gonçalves. Gjuka është shpallur hendbollisti më i mirë i vitit, ndërsa Luna Gonçalves hendbollistja më e mirë e vitit 2022 në Kosovë. Të dy kanë udhëhequr skuadrat Besa Famgas e Istogu drejt titujve të kampionit dhe trofeve të Kupës së Kosovës. Gjuka është shquar edhe me paraqitje te Përfaqësuesja e Kosovës dhe në ndeshjet evropiane të Besa Famgas. Ai për herë të dytë rresht është shpallur hendbollisti më i mirë i vitit në Kosovë.

Shtatëshja më e mirë te hendbollistët përbëhet nga: Arbër Curri (portier – Rahoveci), Oltion Beshiri (alo e majtë – Prishtina), Festim Mustafa (fundor i majtë – Kastrioti), Egzon Gjuka (qendër – Besa Famgas), Rron Ramadani (lojtar i vijës – Prishtina), Arbios Mushkolaj (fundor i djathtë – Besa Famgas), Agon Bajçinovci (alo e djathtë – Prishtina). Ramadani u shpall edhe lojtari më i mirë i mbrojtjes, ndërsa Mustafa ishte golashënuesi më i mirë i vitit 2022. Te hendbollistet, shtatëshen më të mirë e përbëjnë: Blerta Ahmetxhekaj (portiere – Istogu), Argoneta Goqi (alo e majtë – Shqiponja), Burneta Rama (fundore e majtë – Vushtrria), Tainara Luna Gonçalves (qendër – Istogu), Yllka Shatri (lojtare e vijës – Istogu), Natalia Milatoviq (fundore e djathtë – Istogu), Melike Ipçi (alo e djathtë – Prishtina). Shkurta Mehmeti e Prishtinës u shpall hendbollistja më e mirë në mbrojtje, ndërsa Edona Radoniqi e Vëllaznimit ishte golashënuesja më e mirë. Besa Famgas e Istogu u shpallën klubet më të mira të vitit. Faruk Shala i Istogut dhe Verim Zherka i Prishtinës u shpallën trajnerët më të mirë të vitit 2022. Momenti më emocional ishte ndarja e mirënjohjes për Vepër Jetësore për profesorin Beqir Hasanxhekaj.

# Golden State mposhtet në shtesë nga Bostoni



**Boston, 20 janar -** Bostoni mposhti pas kohës shtesë kampionët e Golden States me shifrat 121-118, në një ndeshje spektakolare dhe me shumë rivalitet. Të gjithë titullarët e Warriorsit realizuan mbi 10 pikë (Curry me 29 më i miri), por kjo s'mjaftoi për ta fituar ndeshjen. E njëjta situatë edhe për Celticsin, ku të gjithë titullarët realizuan mbi 10 pikë, ku shkëlqeu Jayson Tatumi me 34 pikë. Chicago mbetet në garë për një vend në "play-off" në Lindje pas fitores me rezultat 126-108 arritur ndaj Detroitit. LaVine me 30 pikë e DeRozani me 26 pikë bënë diferencën në parket për Bullsin në këtë sfidë. Fiton edhe Philadelphia, që falë 32 pikëve të Joel Embiid, mundi me rezultat 105-95 Portlandin. Mirë u paraqit edhe James Hardeni me një "triple double", me 16 pikë, 10 rebounde e 14 asistime. Në ndeshjet e tjera Phoenixi mundi me rezultat 117-112 Brooklynin, që pësoi humbjen e katërt radhazi dhe zbret ndjeshëm në renditje. Bridges me 28 pikë ishte më i miri për Phoenixin, ndërkohë që 40 pikë erdhën nga stoli. Te Netsi vijon të ndihet mungesa e Kevin Durantit. Në sekondat e fundit fiton Minnesota, që mundi me rezultat 128-126 Torontin, ndeshje ku u dallua Russelli me 25 pikë.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Detroit - Chicago | 108-126 |
| Boston - Golden State | 121-118 |
| Minnesota - Toronto | 128-126 |
| Phoenix - Brooklyn | 117-112 |
| Portland - Philadelphia | 95-105 |

## SHKURT

### Guardiola: Fituam tri pikë në ndeshje të çmendur

Manchester City me përmbysje e mposhti Tottenham Hotspurin (2-4). Trajneri Pep Guardiola e ka quajtur këtë ndeshje si të çmendur për faktin se skuadra e tij pas pjesës së parë ishte duke humbur me rezultat 2-0, por në pjesën e dytë realizoi katër gola dhe mori tri pikë të rëndësishme. "Ata janë një skuadër e madhe dhe e provuan edhe një herë këtë. Na mundën në dy ndeshjet e sezonit të shkuar. Do të ishte e rëndësishme të kishim fituar edhe në 'Old Trafford', por nuk e bëmë. Ishte një ndeshje e çmendur dhe fituam tri pikë të rëndësishme për të vazhduar përpara", ka thënë Guardiola.

### Leclerc: Dua titullin këtë sezon

Charles Leclerc, piloti monogask i Ferrarit, kërkon që këtë sezon të realizojë atë që nuk arriti të bëjë vjet, të shpallet kampion bote për pilotë në Formula 1. Përmes një interviste ai shprehet se ndihet në formë dhe se faza përgatitore po shkon mirë.

Leclerc synon të jetë gati për testet që nisin pas një muaji, duke mos i lënë asgjë rastësisë. "Doja që të fitoja që vjet, sidomos pas atij fillimi pozitiv të sezonit, por kjo është jeta. Nuk ia dolëm dot mbanë, por kam si objektiv që të fitoj titullin këtë sezon. Ndaj, këtë herë duhet të jemi më të përgatitur. Po stërvitem fort për të qenë në formë dhe faza përgatitore është pjesë e kësaj pune", ka thënë Leclerc. "Dua të jem në formën optimale kur pilotoj dhe shoh mjaft përmirësim. Dua të jem piloti më i mirë në pistë dhe kjo gjë më motivon. Mendoj se këtë vit jam më i pjekur dhe pas çdo sezoni në Formula 1 mësoj diçka më shumë. Pas çdo gabimi që bëjmë mësojmë diçka, ndaj e shoh veten më të përgatitur për sezonin e ri", ka deklaruar Leclerc.

### Arrestohet Dani Alves

Futbollisti i njohur brazilian Dani Alves është arrestuar në Barcelonë nën dyshimet për sulm seksual në një klub nate. Një grua e ka raportuar mbrojtësin 39-vjeçar më 30 dhjetor të vitit të kaluar se e kishte sulmuar seksualisht në një klub nate. Ndërkaq, Alvesi shkoi në stacionin policor në Mossos D'Esquadra në Barcelonë të premten, për të dëshmuar kundër këtyre supozimeve. "Nuk e di kush është ajo zonja. Ju shkoni në tualet dhe nuk pyesni se kush është aty. Unë kurrë nuk e kam pushtuar hapësirën e askujt. Si do t'ia bëj këtë me një grua apo vajzë? Jo, për Zotin!", ka thënë Alvesi.

### Depay zyrtarizohet tek Atletico Madridi

Atletico Madridi ka zyrtarizuar transferimin e Memphis Depayt nga Barcelona. Sulmuesi holandez ka nënshkruar kontratë të vlefshme deri në verën e vitit 2025. Atletico bëri me dije se reprezentuesi holandez u paraqit të premten në "Civitas Metropolitano" nga ora 18:00. Klubi nga kryeqyteti spanjoll nuk zbuloi tarifën e transferimit të 28-vjeçarit. Sipas raportimeve të mëhershme, Depay thuhet se i ka kushtuar 3 milionë euro.

## Ancelotti 'harron' humbjen nga Barça: Jemi rikthyer

Tronditja e pësuar në "El Clasico", në finale të Superkupës, ka lënë jo pak pasoja në radhët e Real Madridit, kjo u pa qartë në Kupën e Mbretit, në pjesën e parë kundër Villarealit, ku ekipi i Carlo Ancelottit dukej i fjetur, pësoi dy gola duke vënë ndjeshëm në pikëpyetje kualifikimin. Në pjesën e dytë Reali përmbyti rezultatin dhe siguruar një biletë për më tej. "Me sa duket jemi rikthyer. Pjesa e parë nuk shkoi mirë, në këto raste është e vështirë ta ndryshosh dinamikën e lojës, por skuadra pati besim, tregoi karakter dhe personalitet. Kjo pjesë e dytë më jep shumë besim, nuk u dorëzuam dhe luftuam për çdo top. Nuk mund të luajmë si në pjesën e parë, por reagimi ishte spektakolar, kjo skuadër nuk dorëzohet kurrë", ka thënë Ancelotti.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT**
**Komisioni Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale, KRM "Eko-Regjioni", SH.A**
**Nr. 00-111/01-0010011/23**
**Më 19 janar 2023**
**P r i z r e n**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 17 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 6 të Ligjit Nr. 05/L-009, për ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, nenin 6, paragraf 5, nënpar. 5.1, dhe paragraf 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS), nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit Nr. 001/011-4819, i datës 31 mars 2022, Komisioni Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale, KRM "Eko-Regjioni", SH.A, bën rishpalljen e:

**KONKURSIT**

**Për Drejtorë të Bordit të Ndërmarrjes Publike Lokale për:**

1. Ndërmarrja Publike Lokale, KRM "Eko-Regjioni", SH.A – Prizren.

**KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE**

Një kandidat për t'u zgjedhur drejtor i Bordit në Ndërmarrje Publike Lokale, KRM "Eko-Regjioni", Sh.A – Prizren, duhet të ketë kualifikime dhe përvojë pune sipas nenit 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe nenit 6 të Ligjit Nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si vijon:

Çdo person i cili konkurron për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu të përmbush edhe kushte e përshtatshmërisë profesionale si në vijim:

a. Duhet të jetë person që ka integritet të njohur, dukë marr parasysh, ndër tjera, çfarëdo shkelje materiale të detyrave fiduciare që mund të ketë bërë ky person ndaj cilitdo person tjetër;
b. Duhet ose (i) të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë – së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit – në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financave, menaxhimit të thesarit, sektorit bankar, konsulencave në biznes ose industrisë apo edhe në një nga një fushat tjera të shkencave te cilat kanë të bëjnë me veprimtarin afariste të NP-së; ose (ii) për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.

**KUSHTET**

Një person ka të drejtë të shërbejë si drejtor vetëm nëse i plotëson të gjitha kushte më poshtë si dhe kushte për pavarësi dhe përshtatshmëri profesionale të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 17 të këtij ligji;

a. Nuk është dënuar ose vendosur nga një gjykatë kompetente, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë tjetër në bazë të ankesës, se ka kryer vepër penale ose civile vepër penale apo civile që përfshinë përgënjeshtrim, prezantimin e rrejshëm, korrupsionin, vjedhjen, pastrimin e parave, përvetësim, keqpërdorim apo ndarjen e rrejshëm të fondeve ka qenë i përfshirë në mitosje apo ryshfet sipas ligjeve apo rregulloreve në fuqi në Kosovës apo ndonjë vend tjetër, apo sipas traktateve ose konventave ndërkombëtarë;

b. Nuk është vendosur nga një gjykatë ose organ apo organizatë përgjegjëse për zhvillimin e kodit etik apo standardeve të sjelljes profesionale, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga ndonjë gjykatë ose organ tjetër në bazë të ankesës, **(i)** se është angazhuar në sjellje jo profesionale, **(ii)** ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, **(iii)** se ka keq-përvetësuar apo keqpërdorur parat apo burimet publike, **(iv)** se ka keqpërdorur apo keq-përvetësuar informatat (të dhënat) e fituara gjatë shërbimit si zyrtar publik apo shërbyes civil, ose **(v)** se ka keq përdorur postin publik ose postin në shërbimin civil për përfitime personale ose për përfitime apo përparësi te një të afërmi ose të njohuri, apo;
c. Nuk ka bërë përgënjeshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim apo betim tjetër apo ose dokumentin të vulosur apo noterizuar;
d. Nuk është shpallur i falimentuar gjatë (10)viteve të kaluara dhe
e. Nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrje Publike përkatëse ku kandidati punon.

**Kandidati nuk kualifikohet për drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Lokale, nëse:**

a. Aktualisht është zyrtar, ose menaxher i NP përkatëse, ose cilësdo nga filialet e saj, ose ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i NP përkatëse ose cilësdo nga filialet e saj brenda pesë (5) vjetëve të kaluara;
b. Aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të lart në NP-në përkatëse brenda tri (3) viteve të kaluara;
c. Aktualisht ka, ose gjatë tre vjetëve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste *(përveç si konsumator individual i shërbimeve të NP-së)* me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
d. Është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
e. Pranon, ose ka pranuar brenda tre (3) vjetëve të kaluara, kompensim shtesë nga NP përkatëse ose cilado nga filialet e saj *(përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1*, ose është anëtar në skemën pensionale të NP-së përkatëse ose cilësdo nga filialet e saj;
f. Mbanë drejtorësi të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së përkatëse përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe;
g. Përfaqëson në aksionar i cili posedon dhjetë për qind (10%) të aksioneve votuese në NP-në përkatëse;
h. Ka shërbyer në Bordin e Drejtorëve të NP-së përkatëse më shumë se nëntë (9) vjet nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;
i. Është i afërm i shkallës së tretë *(siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" në nenin 2 të këtij Ligji)* i cilitdo person që i takon cilësdo nga kategoritë më sipër përveç personit të përcaktuar në pikën (b); ose
j. Është ose (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare të pa-listuar dhe që konkurron në Ndërmarrjen, ose (ii) menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar *(i cili posedon më shumë se dy për qind (2%)të të drejtave të votimit)*, ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në, cilëndo nga shoqëritë tregtare të listuara që konkurrojnë në Ndërmarrjen; dhe
k. Është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit ka qenë(i) zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
l. Ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij financiare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.

**KOMPENZIMI**

Kompensimi i drejtorëve të Bordeve të Ndërmarrjeve Publike Lokale do të bëhet në bazë të nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe nenit 12 Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

**INFORMATAT TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT**

Kandidatët për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike Lokale duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV, me data të sakta dhe përshkrim të çdo pozicioni të mbajtur;
- Letrën e motivimit;
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Kopjen e letërnjoftimit ose pasaportës (si dëshmi e shtetësisë Kosovare);
- Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duku u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga Gjykata;
- Dëshmitë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHTI ose të këtë dëshmi që është në proces të nostrifikimit);
- Dëshmi të përvojës së punës në postet menaxheriale (dëshmimi i përvojës së punës bëhet nëpërmjet:
    1. Kontratave apo vërtetimeve të punës të lëshuara nga punëdhënësit mbi marrëdhënien e punës dhe
    2. Pasqyrave të kontributeve pensionale, ky kriter i fundit nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion).

Aplikuesi duhet të plotësoj personalisht deklaratën nën betim me rastin e aplikimit, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe të përshtatshmërisë profesionale sipas Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009. Çdo përgënjeshtrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.
Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.
Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Komuna e Prizrenit inkurajon të aplikojnë personat e gjinisë femërore, personat me nevoja të veçanta dhe pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë.

Dokumentacioni duhet të jetë në zarf të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i Ndërmarrjes Publike Lokale në të cilën kandidati konkurron dhe dorëzohet në sportelin Nr. 1,2,3 dhe 4, në objektin e administratës së Përgjithshme të Komunës së Prizrenit, në Rr. Remzi Ademaj pa nr., duke cekur për "Zyrën e Kryesueses së Kuvendit të Komunës".

Afati i konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit në Web faqen e zyrtare të Komunës si dhe në mjetet e informimint **nga data 20 janar 2023 deri me 20 shkurt 2023**.

**Kryesuesi i Komisionit**
**Besnik Krasniqi**

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**PRİZREN BELEDİYE MECLİSİ**
**KRM "Eko-Regjioni", SH.A Yerel Kamu İşletmesi Hissedarları ile ilgili Belediye Komisyonu**
**No. 00-111/01-0010011/23**
**Tarih: 19 Ocak 2022**
**P r i z r e n**

03/L-087 sayılı Kamu İşletme Yasasının 16 ve 17. Maddeleri, 31 Mart 2022 tarihli ve 001/011-4819 sayılı Prizren Belediye Meclis Kararı doğrultusunda ve 07/2017 sayılı Kamu Sektöründe Konkur Prosedürlerinin Düzenlenmesi için İdari Talimatın (ÇSRB) 6. Maddesi, 5. Fıkrası, 5.1. altfıkrası, 6. Fıkrası, 04/L-111 sayılı yasa ile değiştirilip tamamlanan kamu işletmesi ile ilgili 03/L-087 Yasanın değiştirilmesi için 05/L-009 sayılı yasanın 6. Maddesi, 03/L-087 sayılı Kamu İşletme Yasasının değiştirilip tamamlanması için 04/L-111 sayılı hükümleri gereğince KRM "Eko-Regjioni", SH.A Yerel Kamu İşletmesi Hissedarları ile ilgili Belediye Komisyonu aşağıda yer alan konkuru yeniden ilan eder:

1. KRM "Eko-Regjioni", SH.A Yerel Kamu İşletmesi için

**Yerel Kamu İşletme Kurul Müdürü ile ilgili**
**KONKUR**

**KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE**

Bir adayın, KRM "Eko-Regjioni", SH.A Yerel Kamu İşletme Kurul Müdürü olarak seçilmesi için 03/L-087 sayılı Kamu İşletme Yasasının 17. Maddesi, 03/L-087 sayılı Kamu İşletme Yasasının değiştirilip tamamlanması için 04/L-111 sayılı yasanın 9. Maddesi, 03/L-087 sayılı Kamu İşletme Yasasının değiştirilip tamamlanması için 05/L-009 sayılı yasanın 6. Maddesi gereğince kalifiye ve iş tecrübesine sahip olmalıdır:

Müdür konumu için başvuruda bulunan kişiler aşağıdaki mesleki uygunluk şartlarını da yerine getirmelidir:

a. Diğer şeylerin yanı sıra, bu kişinin başka herhangi bir kişiye karşı taahhüt etmiş olabileceği güvene dayalı görevlerin herhangi bir maddi ihlalini dikkate alarak, dürüstlüğü bilinen bir kişi olmalıdır;

b. İşletmecilik, kurumsal finans, finans, hazine yönetimi, bankacılık, Kİ ticari faaliyeti ile ilgili diğer bilim dallarıın birinde ya da işletme veya endüstri danışmanlığı alanında en azından üst düzey yönetimde – (i) en az beş (5) yıl iş tecrübesine sahip olmalı ya da (ii) en az beş (5) yıl kamu muhasebeci, kalifiyeli hukukçu veya Kİ ticari faaliyeti ile yakından bağlantılı olan başka bir mesleğin vasıflı üyesi olmalıdır.

**KOŞULLAR**

Bir kişi, ancak aşağıda yer alan tüm koşulları ve bu Yasanın 17. maddesinin 2. ve 3. fıkralarında belirtilen bağımsızlık ve mesleki uygunluk koşullarını yerine getirdiği takdirde müdür olarak hizmet etme hakkına sahiptir;

a. Yargı yetkisine sahip bir mahkeme tarafından yalan söyleme, yalan beyan, yolsuzluk, hırsızlık, kara para aklama, kötüye kullanma, yanlış fon tahsisi, Kosova'da veya başka herhangi bir ülkede yürürlükte olan yasa veya yönetmelikler veya uluslararası anlaşmalar veya sözleşmeler uyarınca rüşvet veya rüşvet olaylarına karışması içeren cezai veya hukuki bir suç işlediğine dair hüküm giymemiş veya bu tür bir suç veya ceza temyizde başka bir mahkeme tarafından daha sonra geri alınmaması;

b. Bu ceza veya karar daha sonra temyizde başka bir mahkeme veya organ tarafından geri alınmadıkça, bir mahkeme veya kurum veya etik kuralları veya mesleki davranış standartları geliştirmekle sorumlu kuruluş tarafından empoze edilmemiş ise, **(i)** profesyonel olmayan davranışlarda bulundu, **(ii)** etik kurallarını veya profesyonel davranış standartlarını ihlal etti, **(iii)** kamu parasını veya kaynaklarını kötüye kullandığını veya benimsemesi, **(iv)** kamu görevlisi veya memur olarak görevi sırasında edindiği bilgileri (verileri) kötüye kullandığını veya benimsediği, ya da **(v)** kamu görevini veya kamu hizmetindeki konumunu kişisel çıkarı veya bir akraba veya tanıdığına öncelik tanıma veya menfaati için kötüye kullanma, ya da;

c. Herhangi bir yemin altında ya da başka bir yemin ya da mühürlü veya noter tasdikli belge kapsamında maddi tahrifat yapmamıştır;
d. Son (10) yılda iflas ettiği ilan edilmemiş ve
e. Adayın çalıştığı ilgili Kamu İşletme için geliştirme politikaların yapıldığı herhangi bir kurumda çalışmaması.

**Aday Yerel Kamu İşletmesinde Kurul Müdürü olarak aşağıdaki durumlarda kalifiye edilemez:**

a. Halihazırda ilgili Kİ'nin veya herhangi bir yan kuruluşun görevlisi veya yöneticisi olması veya son beş (5) yıl içinde ilgili Kİ'nin veya bağlı şirketlerinin herhangi birinin görevlisi veya yöneticisi olması;
b. Halihazırda ilgili Kİ'nin üst düzey çalışanıdır veya son üç (3) yıl içinde ilgili Kİ'nin üst düzey çalışanı olarak görev yapmıştır;
c. Halihazırda veya son üç yılda ilgili Kİ veya bağlı kuruluşlarından herhangi biri ile doğrudan veya dolaylı olarak herhangi bir maddi iş ilişkisine (Kİ'nin hizmetlerinin bireysel tüketicisi olması dışında) sahip olması;
d. İlgili Kİ veya bağlı olduğu kuruluşlarından herhangi biri ile maddi bir iş ilişkisi olan bir ticari şirkette veya başka bir tüzel kişilikte hissedar, müdür, yetkili veya kıdemli çalışan olması;
e. İlgili Kİ'den veya herhangi bir şubesinden ek tazminat almış veya son üç (3) yıl içinde de almaktadır (20.1. maddesinde belirtilen teşvik edici tazminat ya da Müdür onoresi dışında) veya Kİ veya bağlı kuruluşlarından herhangi birinin emeklilik planının bir üyesi olması;
f. Diğer ticari işletme veya organlara dahil edilmesi aracılığı ile ilgili Kİ'nin diğer yöneticileriyle karşılıklı müdürlükleri veya önemli derecede bağlantıları vardır;
g. Ilişkin KI oylama hisselerin yüzde on (%10) hissesine sahip payı temsil eden;
h. İlk seçildiği tarihten itibaren dokuz (9) yıldan fazla ilgili Kİ Yönetim Kurulu'nda görev yapmış olması;
i. (b) bendinde tanımlanan kişi dışında, yukarıdaki kategorilerden herhangi birine ait herhangi bir kişinin üçüncü derece akrabası olması *(bu Kanunun 2. maddesinde yer alan "Mali Menfaat" tanımına göre belirlenen şekilde)*; veya
j. Çalışan, memur, direktör veya hissedar veya İşletme ile rekabet eden halka açık olmayan bir şirkette finansal çıkarı olan veya (ii) üst düzey yönetici, memur, müdür veya hissedar (yüzde ikiden fazlasına (%2) sahip olan) İşletme içinde rekabet eden borsada işlem gören ticari şirketlerden herhangi birinde oy haklarına sahip olan) veya önemli bir mali menfaati olan ve
k. Başvuru tarihinden önceki 36 aylık süre içinde veya herhangi bir zamanda, bir siyasi partide kamu tarafından seçilmiş bir yetkili, siyasi olarak atanmış veya liderlik veya karar alma pozisyonu sahibi olmuşsa;
l. Doğası gereği, bu kişinin Hissedarlara ve Kİ karşı mali görevlerini rutin, sadakatle, bağımsız ve nesnel bir şekilde yerine getirememesine neden olacak herhangi bir çıkar çatışması olması durumunda.

**TELAFİSİ**

Yerel Kamu İşletme Kurulu Müdürlerin telafisi, Kamu İşletme Kanunun 20.maddesi ve 03/L-087 sayılı Kamu İşletmeleri Kanunun tamamlanması ve değiştirilmesi ile ilişkin 04/L-111 sayılı Kanunun 12.maddesi gereğince yapılacaktır.

**ADAYLARA BAŞVURU SÜRECİ İLE İLİŞKİN GENEL BİLGİLER**

Yerel Kamu İşletme Kurulu Müdürü adayları aşağıdaki belgeleri sunmaları gerekir:

- Tarihlerle birlikte yürüttüğü her pozisyon tanımlaması ile Özgeçmiş;
- Motivasyon mektubu;
- Yemin beyanatı (belgeler teslim edildiği anda doldurulan form);
- Kimlik belgesi veya pasaportun kopyası (Kosova vatandaşı olduğuna dair kanıt);
- Mahkemeden alınacak suç ve cezalanmış kişilere yönelik yürütülmekte olan sürece yönelik kişiler kayıtlarından sertifika (adli sicil);
- Eğitim ve uzmanlık kalifiyesi kanıtları (yurt dışında alınan diplomalar EBTB tarafından denkleştirmeyi yapmalı veya denklik aşamasında olduğunu kanıtlamalıdır);
- Yönetim makamlarında iş tecrübesi kanıtı (iş deneyimi kanıtlaması şu şekilde yapılır):

1. İşverenler tarafından istihdam ilişkisine ilişkin düzenlenen sözleşmeler veya çalışma sertifikaları ve
2. Emeklilik katkı göstergesi, bu kriter Emeklilik Tasarruf fonu kurulmadan önce iş deneyimi için, ayrıca işveren bu kuruma ödeme yükümlülüğü olmayan iş deneyimleri için istenilmez.

Başvuruan başvuru sırasında, 04/L-111 sayılı ve 05/L-009 sayılı Yasa ile yapılan değişiklik ve tamamlamalar ile 03/L-087 sayılı Kamu İşletmeleri Yasası gereğince kalifiye, bağımsız ve profesyonel uygunluk koşullarını yerine getirdiğine dair beyan ettiği yeminli beyanatı şahsen doldurmalıdır. Kasıtlı veya ihmalkâr herhangi bir maddi tahrifat veya yukarıda belirtilen beyanda verilen bilgilerde önemli bir değişiklik yapılması durumunda derhal diskalifiye ile sonuçlanacaktır.

Teslim edilen belgeler geri iade edilmez. Asılları mülakat sırasında talep edilebilir.
Tamamlanmamış başvurular görüşülmeyecektir.
Sadece mülakat için seçilen adaylarla iletişim kurulacaktır.

Prizren Belediyesi kadınları, özel ihtiyaçları olan kişileri ve çoğunluk olmayan toplulukların üyelerini başvurmaya teşvik eder.

Belgeler adayın ad, soyadı ve başvurduğu Yerel Kamu İşletmenin adının yazılı olduğu kapalı zarf içerisinde, "Belediye Meclisi Başkanı Ofisine" belirtilerek Prizren Belediyesi Remzi Ademaj sk. n.n. Genel İdari binasına 1,2,3 ve 4 numaralı gişeden teslim edilir.

İş ilanı Belediyenin internet sayfasında ve basın araçlarına yayımlandığı günden **20 Ocak 2023 tarihinden 20 Şubat 2023 tarihine dek** 30 gün açık olacaktır.

**Komisyon Başkanı**
**Besnik Krasniqi**

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**SKUPŠTINA OPŠTINE PRIZREN**
**Opštinska Komisija Akcionara Lokalnog Javnog Preduzeća, RKO "Eko-Region", A.D.**
**Br. 00-111/01-0010011/23**
**Dana: 19 januar 2023**
**P r i z r e n**

U prilog članu 16. i 17. Zakona br. 03/L-087 za Javna Preduzeća, odredbe Zakona br. 04/L-111, za izmenu i dopunu Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, član 6 Zakona br. 05/L-009, za izmene i dopune Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-111, člana 6, stav 5, podparagraf 5.1, i stav 6 Administrativnog Uputstva (MRSS), br. 07/2017 za uređivanje Procedure Konkursa u Javnom Sektoru, kao i prema Odluci Skupštine opštine Prizren br. 001/011-4819, od 31. marta 2022. godine, Opštinska komisija akcionara lokalnog javnog preduzeća RKO „Eko-Region" AD, ponovo objavljuje:

**KONKURS**

**Za direktore Borda lokalnog javnog preduzeća za:**

1. Lokalno Javno Preduzeće, KRM "Eko-Region", AD - Prizren

**KVALIFIKACIJA I PROFESIONALNA USKLAĐENOST**

Jedan kandidat da bi bio izabran za direktora Borda u Lokalnom javnom preduzeću, KRM „Eko-Region", AD – Prizren, mora imati kvalifikacije i radno iskustvo u skladu sa članom 17. Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, član 9 Zakona br. 04/L-111 za izmenu i dopunu Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća i član 6 Zakona br. 05/L-009 za izmenu i dopunu Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća kako slijedi:

Svako lice koje konkuriše za poziciju direktora mora da ispunjava i sledeće uslove profesionalne usklađenosti kao u nastavku:
a. Mora biti osoba poznatog integriteta, uzimajući u obzir, između ostalog, svaki materijalni prekršaj fiducijarnih dužnosti koju je ta osoba mogla počiniti prema bilo kojoj drugoj osobi;
b. Mora ili (i) imati najmanje pet (5) godina iskustva – barem na nivou višeg menadžmenta – u oblasti poslovne administracije, korporativnih finansija, finansija, upravljanja trezorom, bankarstva, poslovnog savjetovanja ili industrije ili čak u jednoj od ostalih oblasti nauke koje su u vezi sa poslovanjem JP; ili (ii) najmanje pet (5) godina, da je bio javni računovođa, kvalifikovani pravnik ili kvalifikovani član druge profesije koja je usko povezana sa poslovnom aktivnošću JP.

**USLOVI**

Osoba ima pravo da obavlja funkciju direktora samo ako ispunjava sve dole navedene uslove kao i uslove za samostalnost i profesionalnu podobnost iz stava 2. i 3. člana 17. ovog zakona;

a. Nije osuđen ili proglašen od strane nadležnog suda, osim ako takvu osudu ili kaznu naknadno ne poništi drugi sud po žalbi, da je počinio krivično ili građansko djelo koje uključuje falsifikovanje, lažno predstavljanje, korupciju, krađu, pranje novca, pronevjeru, prisvajanje ili je lažna dodela sredstava umešana u podmićivanje ili podmićivanje prema zakonima ili propisima koji su na snazi na Kosovu ili bilo kojoj drugoj zemlji, ili prema međunarodnim ugovorima ili konvencijama;
b. Nije odlučeno od strane suda ili organa ili odgovorne organizacije za razvoj etičkog kodeksa ili standarda profesionalnog ponašanja, osim ako takvu osudu ili odluku naknadno ne poništi bilo koji drugi sud ili tijelo u žalbenom postupku, (i) da se bavio neprofesionalnim ponašanjem, (ii) je prekršio etički kodeks ili standarde profesionalnog ponašanja, (iii) je prisvojio ili zloupotrebio novac ili javna sredstva, (iv) je zloupotrebio ili prisvojio informacije (podatke) stečene tokom obavljanja funkcije javnog funkcionera ili državni službenik, ili (v) da je zloupotrebio javni položaj ili položaj u državnoj službi za ličnu korist ili za korist ili korist rođaka ili poznanika, ili;
c. Nije uradio materijalne prevare pod bilo kojim svjedočenjem pod zakletvom ili drugom zakletvom ili zapečaćenom ili ovjerenom dokumentom;
d. Nije proglašen bankrotom u proteklih (10) godina i
e. Ne radi ni u jednoj instituciji u kojoj se kreiraju razvojne politike za relevantno Javno preduzeće u kojem kandidat radi.

**Kandidat nije kvalifikovan da bude direktor Borda lokalnog javnog preduzeća, ako:**

a. Trenutno je službenik ili menadžer relevantnog JP ili bilo koje njegove filijale, ili je služio kao službenik ili menadžer relevantnog JP ili bilo koje njegove filijale u proteklih pet (5) godina;
